



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT ¹ (NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Data: 17.10.2024

Drejtuar: Operatorit Ekonomik "EGIAN MED" sh.p.k, NUIS L71715003C

Adresa: Njesia bashkiake Nr.7, Rr e Kavajës, Godina Condor Center, Tiranë

Procedura e prokurimit/lotit: "Procedurë e hapur e thjeshtuar" Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Nr. REF-10384-06-21-2024, me objekt "Shërbim 3D (dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim) për ambientet magazinuese rezervë shteti për Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit", me afat 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e Marrëveshjes Kuadër me fond limit 1 249 160 (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa Tvsh.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

¹ Ky Formular është i aplikueshëm nëse ka Ankime

1. Operatori ekonomik “Alpest” sh.p.k. me NUIS M01714005H dhe ofertë ekonomike me vlerë 1,118,530 (një milion e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH;
2. Operatori ekonomik “ALPEN PULITO” sh.p.k. me NUIS K61516506H, oferta nuk hapet;
3. Operatori ekonomik “EGIAN MED” sh.p.k., me NUIS L71715003C dhe ofertë ekonomike me vlerë 1,020,000 (një milion e njëzet mijë) lekë pa TVSH;
4. Operatori ekonomik “MENY-PHARMA” sh.p.k., me NUIS L61329010T dhe ofertë ekonomike me vlerë 685,000 (gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH;
5. Operatori ekonomik “Metani Green” sh.p.k., me NUIS M22010020N dhe ofertë ekonomike me vlerë 999,941.70 (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e dyzet e një pikë shtatëdhjetë) lekë pa TVSH;
6. Operatori ekonomik “NRG” sh.p.k., me NUIS L13426006B dhe ofertë ekonomike me vlerë 942,761 (nëntëqind e dyzet e dy mijë shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “ALPEN PULITO” sh.p.k. për arsye se:

-Në momentin e hapjes së ofertave dt.15.07.2024 në Sistemin e Prokurimit Publik, KVO pasi shkarkon ofertën e operatorit ekonomik në seksionin përkatës , vëren se nuk bëhet e mundur hapja e formatit të kësaj oferte. Për këtë arsye dt.17.07.2024 KVO i drejtohet Agjencisë së Prokurimit Publik për enkriptimin e ofertës dhe në dt.22.07.2024 APP na bën me dije se duhet ti drejtohem operatorit për origjinën e formatit. Në dt.24.07.2024 KVO i drejtohet Operatorit Ekonomik dhe vihet në dijeni nga Operatori se origjina e formatit të ofertës është “.pdf”. KVO procedon me këtë format dhe vëren se nuk është e mundur hapja e këtij formati. Për rrjedhojë Operatori Ekonomik skualifikohet.

2. Operatori ekonomik “MENY-PHARMA” sh.p.k, për arsye se:

- a. Nuk plotëson pikën b) të Seksionit 2 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës.
- b. Nuk plotëson pikën 3 të seksionit 2.3 Kapaciteti Teknik të Kriereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur çertifikatën ose dokumentin e rregjistrimit per produktet biocide në një prej vendeve e percaktuara ne Ligjin 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide ne shëndetin publik”.
- c. Nuk plotëson pikën 4 të seksionit 2.3 Kapaciteti Teknik të Kriereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka arritur të provojë që është i autorizuar nga prodhuesi ose nga

distributorët e autorizuar nga prodhuesi, për lëndët biocide që do të kryhet shërbimi objekt prokurimi.

- d. Nuk plotëson pikën 5 të seksionit 2.3 Kapaciteti Teknik të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur etiketat/katalogët/skedat teknike dhe Dokumentin e të dhënave të Sigurisë për të gjitha produktet biocide ose jo biocide (barriera fizike etj.) në gjuhën shqip.

3. Operatori ekonomik “Metani Green” sh.p.k për arsye se:

- Nuk plotëson pikën 4 të seksionit 2.3 Kapaciteti Teknik të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka arritur të provojë që është i autorizuar nga distributori MILIFAR sh.p.k me NUIS J81426001I, për lëndët biocide që do të kryhet shërbimi objekt prokurimi.

4. Operatori ekonomik “Alpest” sh.p.k. për arsye se:

-Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat formalo-ligjore dhe përcaktimet në DST për paraqitjen e dokumenteve. Konkretisht, Formulari i Vetëdeklarimit (shtojca 9) nuk është i nënshkruar dhe vulosur nga subjekti ofertues. Në paragrafin e fundit të shtojcës 7 të DST **përcaktohet qartë se “Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuar”. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.** Për rrjedhim paraqitja e Formularit të Vetëdeklarimit pa nënshkrim dhe vulë nga subjekti ofertues e bën dokumentin të pavlefshme për qëllime kualifikimi dhe oferta refuzohet.

5. Operatori ekonomik “NRG” shpk për arsye se:

Bazuar në vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1240/2024, skualifikohet për shkak se me dokumentacionin e paraqitur nuk plotëson kërkesat për kualifikim.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik “Egian Med” sh.p.k,** NUIS L71715003C dhe ofertë ekonomike me vlerë 1,020,000 (një milion e njëzet mijë) lekë pa TVSH; se është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a brenda 5 (pese) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO x JO

Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1240/2024

TITULLARI I OPERATORIT TË BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA